



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 18 maj 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi : Publik

Shtojca 1 e Aktgjykimit

Zyrës së Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Valeria Bolici

Methju Holling

Xhejmz Paç

Mbrojtësit të Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

Elinor Stivenson

Mbrojtësit të Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli

Almudena Bernabeu García

1. Më 7 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm autorizoi sekuestrimin nga ZPS-ja të një grupi të parë të dokumenteve që pretendohet se ishin marrë nga OVL-UÇK-ja dhe ndaloi kopjimin dhe shpërndarjen e mëtejshme të dokumenteve dhe të përmbajtjes së tyre.¹
2. Më 17 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm autorizoi sekuestrimin nga ZPS-ja të një grupi të dytë dokumentesh që pretendohet se ishin marrë nga OVL-UÇK-ja dhe ndaloi incizimin apo kopjimin dhe shpërndarjen e mëtejshme të dokumenteve dhe përmbajtjes së tyre.²
3. Më 23 shtator 2020, ZPS-ja njoftoi Gjykatësin e Vetëm se, në përputhje me një urdhër të ZPS-së në bazë të neneve 35(2) dhe 53(1) të Ligjit, më 22 shtator 2020 ajo kishte konfiskuar një grup të tretë dokumentesh që pretendohet se ishin marrë nga OVL-UÇK-ja.³
4. Më 25 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm konstatoi se, meqë urdhri i ZPS-së nuk parashikonte dhe as nuk rezultoi në ndonjë kontrollim apo ndërhyrje me detyrim në selinë e OVL-UÇK-së, dhe meqë dokumentet duket se iu dorëzuan ZPS-së vullnetarisht pas dorëzimit të urdhrin të saj, nuk kishte nevojë për miratim në pajtim me rregullën 38(3) të Rregullores.⁴

¹ F00005, Gjykatësi i Vetëm, *URGJENT, Vendim që Autorizon Sekuestrim*, 7 shtator 2020. *Shih gjithashtu F00028, Prokurori i Specializuar, Raport i Prokurorisë në pajtim me Vendimin KSC-BC-2018-01/F00123, 29 shtator 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale. Shih gjithashtu F00028/RED.*

² F00007, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim për Autorizimin e Sekuestrimit*, 17 shtator 2020. *Shih gjithashtu F00028, Prokurori i Specializuar, Raport i Prokurorisë në pajtim me Vendimin KSC-BC-2018-01/F00123, 29 shtator 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale. Shih gjithashtu F00028/RED.*

³ F00010, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë dhe Kërkesë e Lidhur me Të*, 23 shtator 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale. *Shih gjithashtu F00010/RED.*

⁴ F00017, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorit të Specializuar për Urdhër në lidhje me Dokumente Jopublike dhe Konfidenciale*, 25 shtator 2020, konfidencial, me Shtojcat 1 dhe 2, publike, para. 9. *Shih gjithashtu F00017/RED.*

5. Më 24 shtator 2020, në përputhje me kërkesën e ZPS-së,⁵ Gjykatësi i Vetëm lëshoi fletarrestime për z. Gucati dhe z. Haradinaj,⁶ së bashku me urdhrat për transferimin e tyre në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë (“objekti i paraburgimit i DHS-së”).⁷

6. Gjithashtu më 24 shtator 2020, në përputhje me kërkesën e ZPS-së,⁸ Gjykatësi i Vetëm autorizoi, ndër të tjera, kontrollimin e z. Gucati dhe z. Haradinaj, të vendit të arrestimit të tyre dhe të selisë së OVL-UÇK-së, si dhe sekuestrimin e çfarëdo prove që besohet se kishte lidhje ose ishte e rëndësishme për veprat penale të përmendura në fletarrestimet.⁹

7. Më 25 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm lëshoi urdhër për OVL-UÇK-në dhe për çdo përfaqësues, anëtar, ose person që vepron në emër të saj që: (a) të njoftonin menjëherë ZPS-në nëse kishin në posedim ose do të siguronin në të ardhmen dokumente të tjera që dukej se ishin konfidenciale apo jopublike dhe kishin lidhje me punën e TFHS-së, ZPS-së apo të Dhomave të Specializuara; dhe (b) të mos incizonin, kopjonin, ose shpërndanin dokumente të tilla ose përmbajtjen e tyre pa autorizimin e ZPS-së ose të Gjykatësit të Vetëm.¹⁰

⁵ F00009, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë Urgjente për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe për Urdhra në lidhje me To*, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, 1 tetor 2020. Shih gjithashtu F00009/CONF/RED, konfidenciale; F00009/RED.

⁶ F00012/A01, Gjykatësi i Vetëm, *Fletarrestim për Hysni Gucatin*, 24 shtator 2020, konfidencial dhe *ex parte*; F00012/A03/COR, Gjykatësi i Vetëm, *Version i Korrigjuar i Fletarrestimit për Nasim Haradinajn*, 24 shtator 2020, konfidencial dhe *ex parte*. Shih gjithashtu F00012/A01/RED; F00012/A03/COR/RED.

⁷ F00012/A02, Gjykatësi i Vetëm, *Urdhër për Transferim në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, konfidencial dhe *ex parte*; F00012/A04, Gjykatësi i Vetëm, *Urdhër për Transferim në Objektivin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, konfidencial dhe *ex parte*. Shih gjithashtu F00012/A02/RED; F00012/A04/RED.

⁸ F00009, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë Urgjente për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe për Urdhra në lidhje me To*, 1 tetor 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Shih gjithashtu F00009/CONF/RED, konfidenciale; F00009/RED.

⁹ F00013, *Vendim për Autorizimin e Kontrollimit dhe Sekuestrimit*, 24 shtator 2020, konfidencial dhe *ex parte*; F00014, *Vendim për Autorizimin e Kontrollimit dhe Sekuestrimit*, 24 shtator 2020, konfidencial dhe *ex parte*. Shih gjithashtu F00013/RED; F00014/RED.

¹⁰ F00017/A01, Gjykatësi i Vetëm, *Urdhër në lidhje me Dokumente Konfidenciale dhe Jopublike*, 25 shtator 2020.

8. Më 25 dhe 26 shtator 2020, z. Gucati dhe z. Haradinaj u arrestuan në Kosovë dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të DHS-së.¹¹
9. Përkatësisht më 29 shtator dhe 1 tetor 2020, z. Haradinaj dhe z. Gucati u paraqitën para Gjykatësit të Vetëm.¹²
10. Më 27 tetor 2020, Gjykatësi i Vetëm lëshoi tri vendime mbi kundërshtimet dhe kërkesat e paraqitura nga Mbrojtësi i z. Gucati dhe Mbrojtësi i z. Haradinaj në lidhje me, ndër të tjera, juridiksionin, dispozitat ligjore të zbatueshme dhe çështje të lidhura me arrestimin dhe paraburgimin.¹³
11. Më 29 tetor 2020, Gjykatësi i Vetëm lëshoi një vendim me të cilin përcaktoi se gjuha e punës së procedurave do të ishte anglishtja.¹⁴
12. Më 30 tetor 2020, Prokurori i Specializuar i dorëzoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake për konfirmim Aktakuzën rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* kundër z. Gucati dhe z. Haradinaj.¹⁵
13. Më 9 dhjetor 2020, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi një vendim me të cilin rrëzoi apelin e ndërmjetëm të z. Gucati kundër vendimit të Gjykatësit të Vetëm për çështje të lidhura me arrestimin dhe paraburgimin.¹⁶

¹¹ F00015, Administratorja, *Njoftimi i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020; F00016, Administratorja, *Njoftimi i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020; F00018, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Hysni Gucatit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 25 shtator 2020, me Shtojcën 1, konfidenciale; F00020, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Nasim Haradinajt në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 26 shtator 2020, me Shtojcën 1, konfidenciale.

¹² Transkripti, 29 shtator 2020; Transkripti, 1 tetor 2020.

¹³ F00057, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim mbi Kundërshtimet e Mbrojtjes*, 27 tetor 2020; F00058, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim në Lidhje me Kërkesën për Lirim të Menjëhershëm të Nasim Haradinajt*, 27 tetor 2020; F00059, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim mbi Kërkesën për Dorëzani*, 27 tetor 2020.

¹⁴ F00060, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim për Gjuhën e Punës*, 29 tetor 2020.

¹⁵ F00063, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesave në lidhje me Të*, 30 tetor 2020, konfidencial, me Shtojcat 1-2, konfidenciale.

¹⁶ IA001-F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të Lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e tij në Paraburgim*, 9 dhjetor 2020.

14. Më 11 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e konfirmoi pjesërisht aktakuzën kundër të akuzuarve dhe urdhëroi ZPS-në që të dorëzonte një aktakuzë të rishikuar, e cila u konfirmua.¹⁷

15. Më 18 dhjetor 2020, të akuzuarit bënë paraqitjen e parë para Gjykatësit të Procedurës Paraprake.¹⁸ Z. Gucati u vetëdeklarua i pafajshëm,¹⁹ ndërsa z. Haradinaj refuzoi të vetëdeklarohej në lidhje me fajësinë.²⁰

16. Më 24 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake shqyrtoi nëse ekzistonin ende arsytet për mbajtjen në paraburgim të të akuzuarve dhe urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të tyre.²¹ Pas kësaj, paraburgimi i të akuzuarve u rishikua dhe konfirmua edhe më 24 shkurt 2021,²² 23 prill 2021,²³ 23 qershor 2021,²⁴ 23 gusht 2021,²⁵ 22 tetor 2021,²⁶ 21 dhjetor 2021,²⁷ 21 shkurt 2022,²⁸ and 21 prill 2021.²⁹

¹⁷ F00074, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 11 dhjetor 2020, konfidencial. *Shih gjithashtu* F00074/RED.

¹⁸ Transkripti, 18 dhjetor 2020.

¹⁹ Transkripti, 18 dhjetor 2020, f. 78.

²⁰ Transkripti, 18 dhjetor 2020, f. 58-59.

²¹ F00093, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Hysni Gucatit*, 24 dhjetor 2021; F00094, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt*, 24 dhjetor 2021.

²² F00143, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Hysni Gucatit*, 24 shkurt 2020; F00144, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt*, 24 shkurt 2020.

²³ F00188, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Hysni Gucatit*, 23 prill 2021; F00189, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt*, 23 prill 2021; konfidencial. *Shih gjithashtu* F00189/RED.

²⁴ F00245, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Hysni Gucatit*, 23 qershor 2021; F00246, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt*, 23 qershor 2021.

²⁵ F00279, Trupi Gjykses, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Hysni Gucatit*, 23 gusht 2021; F00280, Trupi Gjykses, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt*, 23 gusht 2021.

²⁶ F00390, Trupi Gjykses, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Hysni Gucatit*, 22 tetor 2021; F00391, Trupi Gjykses, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt*, 22 tetor 2021.

²⁷ F00506, Trupi Gjykses, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Hysni Gucatit*, 21 dhjetor 2021, konfidencial; F00507, Trupi Gjykses, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt*, 21 dhjetor 2021, konfidencial. *Shih gjithashtu* F00506/RED; F00507/RED.

²⁸ F00562, Trupi Gjykses, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Hysni Gucatit*, 21 shkurt 2022; F00563, Trupi Gjykses, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt*, 21 shkurt 2022.

²⁹ F00594, Trupi Gjykses, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Hysni Gucatit*, 21 prill 2022; F00595, Trupi Gjykses, *Vendim për Rishikimin e Paraburgimit të Nasim Haradinajt*, 21 prill 2022.

17. Më 8 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake bëri deklarin e pafajësisë në emër të z. Haradinaj dhe mbajti konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes.³⁰
18. Më 22 janar 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje të lidhura me To, ku përcaktoi parimet dhe afatet e zbatueshme për nxjerrjen e materialeve, përkthimet e dokumenteve dhe të provave, kufizimet për nxjerrjen e materialeve, si edhe sistemin e zbatueshëm të redaktimit.³¹
19. Më 9 shkurt 2021, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi një vendim me të cilin rrëzoi apelin e ndërmjetëm të z. Haradinaj kundër vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për rishikimin e paraburgimit.³²
20. Më 22 shkurt 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi vendim për mosnxjerrjen e shënimeve zyrtare të ZPS-së që përmbanin të dhëna të kontakteve të saj me individë, ku flitej për pasojat e veprimeve të të akuzuarve tek ta.³³
21. Më 23 shkurt 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi vendime për mosnxjerrjen e dokumenteve që iu sekuestruan OVL-UÇK-së më 8, 17 dhe 22 shtator 2020, dhe urdhëroi disa masa kompensuese ndaj mosnxjerrjes së informacionit.³⁴
22. Të njëjtën ditë, më 24 shkurt 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbajti konferencën e dytë për ecurinë e çështjes.³⁵

³⁰ Transkripti, 8 janar 2021, f. 90.

³¹ F00104, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje lidhur me Të*, 22 janar 2021. *Shih gjithashtu* F00121, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Parashtrimet në Lidhje me Kategorizimin sipas Rregullës 109(c)*, 11 shkurt 2021.

³² IA002-F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit për Rishikimin e Paraburgimit*, 9 shkurt 2021.

³³ F00136, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mosnxjerrjen e Kontakteve të Disa Dëshmitarëve*, 22 shkurt 2021, konfidencial. *Shih gjithashtu* F00136/RED. *Shih gjithashtu* vendimet e mëvonshme Gjykatësit të Procedurës Paraprake lidhur me këtë aspekt: Transkripti, 30 mars 2021, f. 214-215 (Urdhër Gojor mbi Kërkesën e ZPS-së për Autorizimin e Redaktimeve Jostandarde); F00185, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Autorizimin e Redaktimeve Jostandarde*, 20 prill 2021.

³⁴ F00141, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Nxjerrjen e Disa Dokumenteve Sekuestruar Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së*, 23 shkurt 2021, konfidencial. *Shih gjithashtu* F00141/RED.

³⁵ Transkripti, 24 shkurt 2021.

23. Më 8 mars 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një vendim mbi mocionet paraprake të Mbrojtjes së z. Gucati (“Mbrojtja e Gucatit”) dhe Mbrojtjes së z. Haradinaj (“Mbrojtja e Haradinajt) (bashkërisht, “Mbrojtja”) ku konstatoi, midis tjerash, se Aktakuza e konfirmuar i përcaktonte me qartësi dhe saktësi të mjaftueshme faktet në të cilat mbështeteshin akuzat dhe krimet, si edhe format e përgjegjesisë penale të paraqitura në Aktakuzë (“Vendimi mbi Mocionet Paraprake”).³⁶

24. Më 15 mars 2021, ekipet e Mbrojtjes dorëzuan kërkesat përkatëse për leje për apelim të Vendimit mbi Mocionet Paraprake.³⁷

25. Më 30 mars 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbajti konferencën e tretë mbi ecurinë e çështjes.³⁸

26. Më 1 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizoi kërkesat e Mbrojtjes për leje për apelim të Vendimit mbi Mocionet Paraprake.³⁹

27. Të njëjtën ditë, më 1 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi vendimin për mosnxjerrjen, midis tjerash, të dokumenteve që ZPS-ja i kishte marrë një organ i medias dhe urdhëroi disa masa kompensuese ndaj mosnxjerrjes së tyre.⁴⁰

³⁶ F00147, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet Paraprake të Mbrojtjes* (“Vendimi mbi Mocionet Paraprake”), 8 mars 2021. *Shih gjithashtu* F00113, Mbrojtja e Gucatit, Mbrojtja e Gucatit, *Mocion Paraprak për Mangësi në Formën e Aktakuzës sipas Rregullës 97(1)(b)*, 30 janar 2021, konfidencial; F00116, Mbrojtja e Haradinajt, *Mocion Paraprak në lidhje me Mangësitë në Aktakuzë*, 3 shkurt 2021. *Shih gjithashtu* F00113/RED; F00116/RED.

³⁷ F00151, Mbrojtja e Gucatit, *Kërkesë për Leje për Apelim të Vendimit KSC-BC-2020-07/F00147 sipas Nenit 45(2) dhe Rregullës 77(1)*, 15 mars 2021; F00153, Mbrojtja e Haradinajt, *Kërkesë për Leje për Apelim të Vendimit KSC-BC-2020-07/F00147 sipas Nenit 45(2) dhe Rregullës 77(1)*, 15 mars 2021.

³⁸ Transkripti, 30 mars 2021.

³⁹ F00169, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionet Paraprake të Mbrojtjes*, 1 prill 2021.

⁴⁰ F00171, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Mosnxjerrjen e Informacionit të Kërkuar nga Mbrojtja*, 1 prill 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. *Shih gjithashtu* F00171/CONF/RED, konfidencial; F00171/CONF/RED2, konfidencial.

28. Gjithashtu më 1 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një vendim mbi rëndësinë materiale të informacionit të kërkuar nga Mbrojtja sipas rregullës 102(3) të Rregullores dhe çështje në lidhje me të.⁴¹

29. Më 9 prill 2021, ZPS-ja dorëzoi dosjen e saj paraprake, listën e dëshmitarëve, listën provave materiale të propozuara dhe tabelën së nxjerrjes së materialeve sipas rregullës 109(c).⁴²

30. Më 30 prill 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbajti konferencën e katërt mbi ecurinë e çështjes.⁴³

31. Më 26 maj 2021, në vijim të parashtrimeve nga palët,⁴⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një vendim me të cilin refuzoi kërkesën për nxjerrjen e disa materialeve të kërkuara nga Mbrojtja sipas rregullës 102(3) të Rregullores (“Vendimi i 26 Majit 2021”).⁴⁵

32. Më 28 maj 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbajti konferencën e pestë mbi ecurinë e çështjes.⁴⁶

⁴¹ F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Rëndësinë Materiale të Informacionit të Kërkuar në Përputhje me Rregullën 102(3) dhe Çështje të Lidhura me Të, 1 prill 2021*, konfidencial. *Shih gjithashtu F00172/RED.*

⁴² F00181, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Dosjes Paraprake, Listave të Dëshmitarëve e Provave Materiale dhe Tabelës sipas Rregullës 109(c), 9 prill 2021, me Shtojcën 1 (“Dosja Paraprake e ZPS-së”) dhe Shtojcat 2-4*, konfidenciale. *Shih gjithashtu F00181/A01/RED.*

⁴³ Transkripti, 30 prill 2021.

⁴⁴ F00190, Prokurori i Specializuar, *Kërkesat dhe Kundërshtimet e Prokurorisë në Pajtim me KSC-BC-2020-07/F00172*, 26 prill 2021, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00199, Mbrojtja e Gucatit, *Përgjigje ndaj Versionit të Redaktuar Konfidencial të ‘Kërkesave dhe Kundërshtimeve të Prokurorisë në Përputhje me KSC-BC-2020-07/F00172’, KSC-BC-2020-07/F00190 të datës 26 prill 2020, 10 maj 2021*, konfidenciale; F00200, Mbrojtja e Haradinajt, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Versionit të Redaktuar Konfidencial të ‘Kërkesave dhe Kundërshtimeve të Prokurorisë në Përputhje me KSC-BC-2020-07/F00172’, dhe F00190, 11 maj 2021. Shih gjithashtu F00190/CONF/RED, konfidenciale; F00190/RED; F00199/RED.*

⁴⁵ F00210, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesat dhe Kundërshtimet e Prokurorisë në bazë të F00172 (“Vendimi i 26 Majit 2021”), 26 maj 2021. Shih gjithashtu F00210/RED.*

⁴⁶ Transkripti, 28 maj 2021.

33. Më 15 qershor 2021, në vijim të kërkesës për autorizim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi lejen për apelimin e Vendimit të 26 Majit 2021.⁴⁷
34. Të njëjtën ditë, më 23 qershor 2021, paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi vendimin mbi apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit për Mocionet Paraprake dhe, pasi konstatoi se aktakuzës i mungonte konkretësia, urdhëroi panelin kompetent që të urdhëronte ZPS-në të parashtronte një version të korrigjuar të Aktakuzës mbi bazën e udhëzimeve të tij.⁴⁸
35. Gjithashtu më 23 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi ZPS-në të dorëzonte versionin e korrigjuar të aktakuzës dhe i informoi palët se transferimi i Dosjes së Çështjes sipas rregullës 98(1) të Rregullores ishte caktuar për të premtën, 16 korrik 2021.⁴⁹
36. Më 5 korrik 2021, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e korrigjuar (“Aktakuza”).⁵⁰
37. Më 12 korrik 2021, ekipet e Mbrojtjes dorëzuan Dosjet Paraprake, listat e dëshmitarëve të mundshëm, listat e kundërshtimeve ndaj pranueshmërisë së provave dhe listat e fakteve të pranuar nga palët.⁵¹
38. Më 14 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mbajti konferencën e gjashtë dhe të fundit mbi ecurinë e çështjes në kuadër të fazës paraprake. Palët nuk patën

⁴⁷ F00235, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Kërkesat B-C të Gucatit*, 15 qershor 2021.

⁴⁸ IA004-F00007, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelet e Mbrojtjes kundër Vendimit mbi Mocionet Paraprake*, 23 qershor 2021.

⁴⁹ F00244, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Dorëzimin e Aktakuzës së Korrigjuar dhe për një Kalendar të Dytë të Rishikuar për Pjesën e Mbetur të Procedurës Paraprake*, 23 qershor 2021.

⁵⁰ F00251/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojcë 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Korrigjuar (“Aktakuza”)*, 5 korrik 2021, konfidenciale. *Shih gjithashtu F00251/A02, Prokurori i Specializuar, Shtojcë 2 e Parashtrimit të Aktakuzës së Korrigjuar*, 5 korrik 2021. *Shih gjithashtu F00251/A01/RED.*

⁵¹ F00258, Mbrojtja e Gucatit, *Dosja Paraprake e Mbrojtjes së Hysni Gucatit*, 12 korrik 2021, konfidenciale, me Shtojcat 1-3, konfidenciale; F00260, Mbrojtja e Haradinajt, *Parashtrim i Dosjes së Ndërmjetme Paraprake të Mbrojtjes së Nasim Haradinajt*, 12 korrik 2021, konfidencial, me Shtojcat 1-2, konfidenciale. *Shih gjithashtu F00258/RED, F00260/RED.*

kundërshtime që dosja e çështjes gjyqësore t'i kalohej Trupit Gjyqësor më 16 korrik 2021.⁵²

39. Më 14 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake njoftoi Kryetaren se dosja e çështjes gjyqësore do të ishte e gatshme për t'iu kaluar Trupit Gjyqësor të premtën, më 16 korrik 2021.⁵³

40. Më 15 korrik 2021, pas dorëzimit të dosjes së çështjes, Kryetarja caktoi Trupin Gjyqësor II ("Trupi Gjyqësor") për këtë çështje gjyqësore.⁵⁴

41. Më 16 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ia kaloi dosjen e çështjes Trupit Gjyqësor në përputhje me rregullën 98 të Rregullores.⁵⁵

42. Gjithashtu më 16 korrik 2021, Trupi Gjyqësor zgjodhi njëzëri gjykatësin Çarls L. Smith III, si kryegjykatës të tij.⁵⁶

43. Më 21 korrik 2021, Trupi Gjyqësor lëshoi një urdhër për paraqitjen e parashtrimeve me shkrim dhe caktoi datat 1 dhe 2 shtator 2021 për mbajtjen e konferencës përgatitore për gjykimin.⁵⁷

44. Më 29 korrik 2021, paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi vendimin me të cilin rrëzoi apelet e ndërmjetme të Mbrojtjes kundër vendimit të Gjykatës të Procedurës Paraprake të 26 majit 2021 ("Vendimi i Panelit të Gjykatës së Apelit i 26 Korrikut 2021").⁵⁸

⁵² Transkripti, 14 korrik 2021, f. 374-376.

⁵³ F00261, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Njoftim në përputhje me Rregullën 98(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave*, 14 korrik 2021.

⁵⁴ F00263, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Trupit Gjyqësor II*, 15 korrik 2021.

⁵⁵ F00265, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për Kalimin e Dosjes së Çështjes Trupit Gjyqësor II*, 16 korrik 2021.

⁵⁶ F00266, Trupi Gjyqësor, *Vendim për Njoftimin e Zgjedhjes së Kryegjykatësit*, 16 korrik 2021.

⁵⁷ F00267, Trupi Gjyqësor, *Urdhër për Parashtrime dhe për Caktimin e Datave për Mbajtjen e Konferencës Përgatitore për Gjykimin*, 21 korrik 2021.

⁵⁸ IA005-F00008, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelet kundër Vendimit për Nxjerrje të Informacionit* ("Vendimi i Panelit të Gjykatës së Apelit i 26 Korrikut 2021"), 29 korrik 2021, konfidencial. IA005-F00008.

45. Më 1 dhe 2 shtator 2021, Trupi Gjykses mbajti konferencën përgatitore për gjykimin dhe caktoi datat e konferencës përgatitore për Prokurorin e Specializuar.⁵⁹

46. Më 1 shtator 2021, Trupi Gjykses urdhëroi ZPS-në të dorëzonte njoftimin e përditësuar sipas rregullës 102(3), me listën e të gjitha materialeve në zotërim të saj që ishin objekt i konstatimeve në Vendimin e Panelit të Gjykatës së Apelit të 26 Korrikut 2021.⁶⁰ Të njëjtën ditë, ZPS-ja kërkoi të dorëzonte një kërkesë për masa mbrojtëse në lidhje me njoftimin e përditësuar sipas rregullës 102(3).⁶¹

47. Më 2 shtator 2021, Trupi Gjykses dëgjoi parashtrime gojore nga të dyja palët lidhur me njoftimin e përditësuar sipas rregullës 102(3).⁶² Të njëjtën ditë, Trupi Gjykses mbajti një seancë *ex parte* vetëm me ZPS-në për të dëgjuar parashtrimet e saj lidhur me redaktimet e kërkuara.⁶³ Në vijim të këtyre parashtrimeve, Trupi Gjykses urdhëroi ZPS-në që, deri më 3 shtator 2021, t'i dorëzonte vetëm Trupit Gjykses: (i) një version të parë të përdiktuar të njoftimit sipas rregullës 102(3), ku të jepte njoftim të hollësishëm për materialin përkatës, për t'i mundësuar Mbrojtjes të përcaktonte rëndësinë materiale të tij; dhe (ii) propozimin për një version të rediktuar të së njëjtës listë.⁶⁴

48. Më 3 shtator 2021, ZPS-ja parashtroi një version të parë, të përdiktuar të njoftimit të përditësuar sipas rregullës 102(3) dhe propozimin e versionit të rediktuar të tij.⁶⁵

49. Më 7 shtator 2021, Trupi Gjykses konstatoi se materialet në versionin e parë të njoftimit të përditësuar sipas rregullës 102(3), së paku në pamje të parë, dukeshin se ishin objekt i nxjerrjes sipas rregullës 102 dhe/ose 103 të Rregullores. Rrjedhimisht,

⁵⁹ Transkriptet e datave 1-2 shtator 2021; Transkripti, 2 shtator 2021, f. 604 (Urdhër Gojor për Caktimin e Datës së Konferencës Përgatitore për ZPS-në).

⁶⁰ Transkripti, 1 shtator 2021, f. 442-443 (Urdhër Gojor për Kalendarin e Nxjerrjes së Provave sipas Rregullës 102(3)).

⁶¹ Transkripti, 1 shtator 2021, f. 443.

⁶² Transkripti, 2 shtator 2021, f. 561-600.

⁶³ Transkripti, 2 shtator 2021, konfidencial dhe *ex parte*, f. 606-637.

⁶⁴ Transkripti, 2 shtator 2021, f. 638 (Urdhër Gojor lidhur me Listën e ZPS-së sipas Rregullës 102(3)).

⁶⁵ F00296, Prokurori i Specializuar, *Propozim i Prokurorisë për Rediktme në Njoftimin sipas Rregullës 102(3)*, 3 shtator 2021, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

Trupi Gjykses urdhëroi ZPS-në të dorëzonte një njoftim të përditësuar sipas rregullës 102(3), të redaktuar.⁶⁶

50. Më 7 shtator 2021, Trupi Gjykses refuzoi kërkesën e ZPS-së për masa mbrojtëse për dy prej dëshmitarëve të saj.⁶⁷

51. Më 8 shtator 2021, Trupi Gjykses mbajti konferencën përgatitore për Prokurorin e Specializuar dhe caktoi datën për hapjen e çështjes gjyqësore.⁶⁸ Trupi Gjykses gjithashtu caktoi datën e synuar për mbylljen e paraqitjes së provave nga Prokurori i Specializuar dhe mbylljen e çështjes gjyqësore.⁶⁹

52. Më 9 shtator 2021, ZPS-ja dorëzoi njoftimin e përditësuar sipas rregullës 102(3), të redaktuar.⁷⁰

53. Më 13 shtator 2021, të dy ekipet e Mbrojtjes kërkuan që ZPS-ja të nxirrte të gjitha materialet në listën e njoftimit sipas rregullës 102(3), gjë që ZPS-ja e kundërshtoi.⁷¹

54. Më 17 shtator 2021, Trupi Gjykses lëshoi urdhrin lidhur me zhvillimin e procedurave dhe përcaktoi se gjuha e punës e procesit gjyqësor do të ishte anglishtja (“Urdhri për Zhvillimin e Procedurave”).⁷²

⁶⁶ F00304, Trupi Gjykses, *Urdhër lidhur me Njoftimin e Hollësishëm të Përditësuar sipas Rregullës 102(3)*, 7 shtator 2021, me Shtojcën 1, konfidenciale dhe *ex parte*.

⁶⁷ F00303, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Masa Mbrojtëse*, 7 shtator 2021.

⁶⁸ Transkripti, 8 shtator 2021, f. 708-709 (Urdhër Gojor mbi Kalendarin e Seancave Gjyqësore).

⁶⁹ Transkripti, 8 shtator 2021, f. 708-709 (Urdhër Gojor mbi Kalendarin e Seancave Gjyqësore).

⁷⁰ F00307, Prokurori i Specializuar, *Shtesë e Njoftimit Përmbledhës të Prokurorisë sipas Rregullës 102(3) 102(3)*, 9 shtator 2021, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, konfidenciale. *Shih gjithashtu* F00307/RED.

⁷¹ F00316/COR, Prokurori i Specializuar, *Version i Korrigjuar i Kundërshtimeve të Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialeve në Njoftimin e Përditësuar sipas Rregullës 102(3)*, 17 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 13. F00325/COR, Mbrojtja e Gucatit, *Version i Korrigjuar i Përgjigjes ndaj Versionit Konfidencial të Redaktuar të Kundërshtimeve të Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialeve në Njoftimin e Përditësuar sipas Rregullës 102(3)*, 1 tetor 2021, para. 8. F00326, Mbrojtja e Haradinajt, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Kundërshtimeve të Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialeve në Njoftimin e Përditësuar sipas Rregullës 102(3)*, 24 shtator 2021. *Shih gjithashtu* F00316, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00316/CONF/RED, konfidenciale; F00316/RED; F00325, konfidenciale, F00325/COR/RED.

⁷² F00314, Trupi Gjykses, *Urdhër mbi Zhvillimin e Procedurave*, 17 shtator 2021.

55. Më 22 shtator 2021, Trupi Gjykses urdhëroi ZPS-në të bënte parashtrime të mëtejshme lidhur me kundërshtimet për nxjerrjen e materialeve që u shtuan në njoftimin sipas rregullës 102(3), përfshirë “bazën faktike ku mbështetet pretendimi i saj se materialet 195-200 nuk përmbajnë informacion me rëndësi materiale për [pretendimin për shtytje për kryerje të veprës penale]”.⁷³

56. Më 27 shtator 2021, Trupi Gjykses lëshoi një vendim me të cilin refuzoi kërkesën e Mbrojtjes për mospranimin e disa provave të caktuara që lidheshin me dy dëshmitarë të ZPS-së.⁷⁴

57. Më 28 shtator 2021, në përputhje me urdhrin e Trupit Gjykses, ZPS-ja dorëzoi, vetëm për Trupin Gjykses, parashtrime të mëtejshme mbi disa nga materialet e renditura në njoftimin e përditësuar sipas rregullës 102(3).⁷⁵

58. Më 29 shtator 2021, në vijim të kërkesës së ZPS-së për pranimin e provave jогоjore,⁷⁶ Trupi Gjykses lëshoi vendimin (“Vendimi mbi Provat Jогоjore të ZPS-së”) me të cilin pranoi një numër provash jогоjore,⁷⁷ refuzoi pranimin e disa materialeve të caktuara⁷⁸ dhe shtyu vendimin për të gjitha materialet e tjera deri në kohën kur ato të paraqiteshin përmes dëshmitarëve përkatës në gjykim.⁷⁹

⁷³ F00320, Trupi Gjykses, *Urdhër për Parashtrime të Mëtejshme në Lidhje me Kundërshtimet e Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialeve në Njoftimin e Përditësuar sipas Rregullës 102(3)*, 22 shtator 2021.

⁷⁴ F00328, Trupi Gjykses, *Urdhër mbi Mocionet e Mbrojtjes sipas Rregullës 117*, 27 shtator 2021.

⁷⁵ F00331, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Prokurorisë në pajtim me KSC-BC-2020-07/F00320*, 28 shtator 2021.

⁷⁶ F00291, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Pranimin e Provave Jогоjore*, 31 gusht 2021, me Shtojcën 1, konfidenciale; F00308, Mbrojtja e Gucatit, *Përgjigje ndaj Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Provave Jогоjore*, 10 shtator 2021, konfidenciale. F00309, Mbrojtja e Haradinajt, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Parashtrimeve të ZPS-së për Pranimin e Provave Jогоjore*, 10 shtator 2021, konfidenciale; F00311, Prokurori i Specializuar, *Kundërpërgjigje e Prokurorisë ndaj Përgjigjeve të Mbrojtjes në lidhje me Kërkesën për Pranimin e Provave Jогоjore*, 14 shtator 2021. *Shih gjithashtu F00308/RED; F00309/RED.*

⁷⁷ F00334, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Pranimin e Provave Jогоjore* (“Vendimi mbi Provat Jогоjore të ZPS-së”), 29 shtator 2021, para. 96(b).

⁷⁸ Vendimi mbi Provat Jогоjore të ZPS-së, para. 96(e).

⁷⁹ Vendimi mbi Provat Jогоjore të ZPS-së, para. 96(f).

59. Më 29 shtator 2021, ZPS-ja dorëzoi një parashtrim, mbi baza rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, për përcjelljen e një shënimi zyrtar lidhur me kontaktin që kishte pasur para pak kohe me një dëshmitar ("shënimi zyrtar për kontaktin").⁸⁰

60. Më 4 tetor 2021, Trupi Gjykses mbajti një seancë *ex parte* vetëm me ZPS-në, për të dëgjuar parashtrime të mëtejshme mbi shënimin zyrtar për kontaktin.⁸¹

61. Më 7 tetor 2021, në vijim të seancës *ex parte*, Trupi Gjykses urdhëroi ZPS-në që të dorëzonte një shtesë tjetër të njoftimit të përditësuar sipas rregullës 102(3), ku të përfshinte shënimin zyrtar për kontaktin dhe ku të jepte njoftim të hollësishëm të përmbajtjes së tij në mënyrë që t'i mundësonte Mbrojtjes të: (i) përcaktonte nëse dokumenti ishte juridikisht thelbësor për të; dhe, nëse po, (ii) t'i bënte ZPS-së kërkesë për nxjerrje të materialeve ("Urdhri për Shtesë të Njoftimit").⁸²

62. Më 7 tetor 2021, Kryegjykatësi i Trupit Gjykses hapi gjykimin dhe ZPS-ja lexoi Aktakuzën.⁸³ Të akuzuarit bënë me dije se e kishin kuptuar Aktakuzën dhe konfirmuan vetëdeklarimin e tyre si të pafajshëm.⁸⁴ Në vijim, Kryegjykatësi i informoi të akuzuarit për të drejtat dhe detyrimet e tyre.⁸⁵ Të njëjtën ditë, më 7 tetor 2021, ZPS-ja mbajti deklaratën e saj hyrëse.⁸⁶

⁸⁰ F00337, Prokurori i Specializuar, *Përcjellje nga Prokuroria e Shënimit Zyrtar për Kontaktin dhe Kërkesë lidhur me Të*, 29 shtator 2021, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. *Shih gjithashtu* F00337/CONF/RED, konfidenciale.

⁸¹ Transkripti, 4 tetor 2021, konfidencial dhe *ex parte*, f. 713-746. *Shih gjithashtu* F00346, Trupi Gjykses, *Urdhër për Caktimin e Datës për Seancë Ex Parte*, 1 tetor 2021, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

⁸² F00354, Trupi Gjykses, *Urdhër për Shtesë të Njoftimit të Hollësishëm të Përditësuar sipas Rregullës 102(3)* ("Urdhri për Shtesë të Njoftimit"), 7 tetor 2021, para. 11.

⁸³ Transkripti, 7 tetor 2021, f. 747, 752-777.

⁸⁴ Transkripti, 7 tetor 2021, f. 777-779.

⁸⁵ Transkripti, 7 tetor 2021, f. 779-780.

⁸⁶ Transkripti, 7 tetor 2021, f. 784-813.

63. Më 13 tetor 2021, në përputhje me Urdhrin për Shtesë të Njoftimit, ZPS-ja dorëzoi shtesën e njoftimit të përditësuar sipas rregullës 102(3), në të cilin kishte shtuar një material.⁸⁷

64. Më 18 tetor 2021, Trupi Gjykes i informoi palët se do të shtynte dhënien e vendimit përmbledhës lidhur me aspektet e patrajuara të rregullës 102(3) deri pasi të kishte dëgjuar dëshmitë e dy dëshmitarëve të ZPS-së, sepse ato mund të ndikonin në vendimin e Trupit Gjykes mbi nxjerrjen e materialeve.⁸⁸

65. Më 18 tetor 2021, filloi paraqitja e provave nga Prokurori i Specializuar.⁸⁹ Sikurse përshkruhet në vijim, Trupi Gjykes dëgjoji dëshmitë e ZPS-së gjatë seancave që zgjatën dhjetë (10) ditë.

66. Midis 18 dhe 26 tetorit 2021, Trupi Gjykes dëgjoji dëshminë e Zdenka Pumperit (W04841). Gjatë dëshmisë së saj, disa prova materiale u shënuan për identifikim deri në marrjen e vendimit mbi pranueshmërinë e tyre, dhe ZPS-ja dorëzoi “prova materiale shoqëruese” që u paraqitën për praninë së bashku me deklaratat e W04841-it.⁹⁰

67. Më 21 tetor 2021, Trupi Gjykes mbajti një tjetër seancë *ex parte* vetëm me ZPS-në për të dëgjuar parashtrimet e saj lidhur me aspekte ende të patrajuara lidhur me nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 102(3) dhe masa kompensuese të mundshme.⁹¹

68. Më 22 tetor 2021, ZPS-ja parashtrroi kundërshtimin e saj për nxjerrjen e shtesës së njoftimit të përditësuar sipas rregullës 102(3) si dhe bëri propozime për masa

⁸⁷ F00361, Prokurori i Specializuar, *Përditësim i Prokurorisë i Shtesës së Njoftimit sipas Rregullës 102(3)*, 13 tetor 2021, konfidencial.

⁸⁸ Transkripti, 18 tetor 2021, f. 816-817.

⁸⁹ Transkripti, 18 tetor 2021, f. 831.

⁹⁰ W04841 (Zdenka Pumper), Transkriptet e datave 18-26 tetor 2021, f. 831-1490; F00397, *Parashtrim i Prokurorisë mbi Provat Materiale Shoqëruese për W04841-shin*, 25 tetor 2021, me Shtojcën 1, konfidenciale. Më 28 tetor 2021, Trupi Gjykes dëgjoji parashtrimet gojore të palëve lidhur me pranueshmërinë e materialeve të shënuara për identifikim. Transkripti, 28 tetor 2021, f. 1654-1686.

⁹¹ Transkripti, 21 tetor 2021, konfidencial dhe *ex parte*, f. 1254-1301. *Shih gjithashtu* F00382, Trupi Gjykes, *Urdhër për Caktimin e Datës për Seancë Ex Parte*, 19 tetor 2021, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

kompensuese.⁹² Përkatësisht më 27 dhe 29 tetor 2021, u dorëzuan përgjigjet e secilit prej ekipeve të Mbrojtjes.⁹³ ZPS-ja u kundërpërgjigj më 1 nëntor.⁹⁴

69. Midis 26 tetorit dhe 5 nëntorit 2021, Trupi Gjykses dëgjoji dëshmitë e tre dëshmitarëve të tjerë të ZPS-së: Halil Berishës (W04866), Miro Jukiqit (W04842) dhe Daniel Mobergut (W04876).⁹⁵

70. Më 3 nëntor 2021, Trupi Gjykses lëshoi vendimin përmbledhës për një numër kërkesash të ZPS-së për mosnxjerrje të materialeve sipas rregullës 102(3) të Rregullores ("Vendimi i 3 Nëntorit 2021"), me të cilin urdhëroi mosnxjerrjen e disa materialeve të caktuara dhe disa masa kompensuese ndaj mosnxjerrjes së tyre, konkretisht që Mbrojtjes t'i jepeshin pjesë të një materiali dhe një përmbledhje e hapave dhe verifikimeve të ndërmarra nga ZPS-ja në lidhje me gjashtë materiale të tjera, si edhe masa të mëtejme që duhet të merrte ZPS-ja në lidhje me shënimin zyrtar për kontaktin.⁹⁶

71. Më 5 nëntor 2021, ZPS-ja kërkoi leje për apelimin e Vendimit të 3 Nëntorit 2021.⁹⁷ Të njëjtën ditë, Trupi Gjykses i informoi palët se për të mundësuar zhvillimin e shpejtë

⁹² F00389, Prokurori i Specializuar, *Kundërshtim i Prokurorisë dhe Propozim për Masa Kompensuese në lidhje me Njoftimin sipas Rregullës 102(3)*, 22 tetor 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcën 1, konfidenciale. Shih gjithashtu F00389/CONF/RED; F00389/RED.

⁹³ F00404/RED, Mbrojtja e Haradinajt, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj 'Kundërshtimit të Prokurorisë ndaj Nxjerrjes së Materialeve dhe Propozimit për Masa Kompensuese në lidhje me Njoftimin sipas Rregullës 102(3)'*, 27 tetor 2021; F00407/RED, Mbrojtja e Gucatit, *Përgjigje ndaj 'Versionit Publik të Redaktuar të Kundërshtimit të Prokurorisë ndaj Nxjerrjes së Materialeve dhe Propozimit për Masa Kompensuese në lidhje me Njoftimin sipas Rregullës 102(3) dhe Kërkesë Plotësuese*, 29 tetor 2021, konfidenciale. Shih gjithashtu F00404/RED; F00407/RED.

⁹⁴ F00409, Prokurori i Specializuar, *Kundërpërgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Përgjigjeve ndaj Kundërshtimit ndaj Nxjerrjes së Materialeve dhe Propozimit për Masa Kompensuese*, 1 nëntor 2021.

⁹⁵ W04866 (Halil Berisha), Transkriptet, 26-27 tetor 2021, f. 1512-1640; W04842 (Miro Jukiq), Transkriptet, 28 tetor-4 nëntor 2021, f. 1689-1907; W04876 (Daniel Moberg), Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1929-1961.

⁹⁶ F00413, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kundërshtimet e Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialeve në Njoftimin e Përditësuar sipas Rregullës 102(3)*, 3 nëntor 2021, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Shih gjithashtu F00413/RED.

⁹⁷ F00420, Prokurori i Specializuar, *Kërkesa të Prokurorisë për Leje për Apelim të Vendimit KSC-BC-2020-07/F00413 dhe për Efekt Pezullues*, 5 nëntor 2021.

të procesit, do të dëgjonte parashtrime me gojë me përgjigje dhe kundërpërgjigje nga Mbrojtja dhe ZPS-ja.⁹⁸

72. Më 5 nëntor 2021, Trupi Gjykses lëshoi një urdhër gojor mbi provat materiale të shënuara për identifikim gjatë dëshmisë së W04841-shit dhe “provat materiale shoqëruese”, me të cilin i pranoi të gjitha provat materiale me përjashtim të tri prej tyre.⁹⁹ Arsyet me shkrim pasuan më 9 nëntor 2021.¹⁰⁰

73. Më 8 nëntor 2021, ZPS-ja bëri të ditur se nuk do të thërriste dëshmitarë të tjerë.¹⁰¹

74. Më 8 nëntor 2021, Trupi Gjykses dëgjoi parashtrime me gojë nga palët lidhur me kërkesat e ZPS-së për leje për apelim të Vendimit të 3 Nëntorit 2021.¹⁰² Të njëjtën ditë, Trupi Gjykses lëshoi një vendim me të cilin i refuzoi ZPS-së lejen për të apeluar atë vendim dhe përsëriti urdhrin e që ZPS-ja t'i dorëzonte Mbrojtjes materialet e identifikuar në Vendimin e 3 Nëntorit 2021.¹⁰³

75. Më 9 nëntor 2021, Trupi Gjykses lëshoi një urdhër për planin e punës dhe afatet për hapat e mëtejshëm në gjykim (“Urdhri për Planin e Punës i 9 Nëntorit 2021”).¹⁰⁴ Trupi Gjykses urdhëroi Prokurorin e Specializuar që të mbyllte zyrtarisht paraqitjen e provave në përputhje me rregullën 129 të Rregullores, caktoi afate për dorëzimin e parashtrimeve sipas rregullës 130 të Rregullores, si dhe përcaktoi data paraprake për konferencën përgatitore për Mbrojtjen, dorëzimin e parashtrimeve sipas rregullës 119 të Rregullores dhe hapjen e paraqitjes së provave prej Mbrojtjes.¹⁰⁵

⁹⁸ F00417, Trupi Gjykses, *Rendi i Ditës për Seancën e 8 Nëntorit 2021*, 5 nëntor 2021.

⁹⁹ Transkripti, 5 nëntor 2021, f. 1912-1914 (Urdhër Gojor për Pranimin e Provave Materiale Përmes Dëshmitarit W04841).

¹⁰⁰ F00427, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Pranueshmërinë e Provave Materiale të Shtyra dhe Klasifikimin e Disa Provave Materiale të Pranuarra*, 9 nëntor 2021.

¹⁰¹ Transkripti, 8 nëntor 2021, f. 2041.

¹⁰² Transkripti, 8 nëntor 2021, f. 1974-2029.

¹⁰³ F00423, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesat e Prokurorisë për Leje për Apelimin e F00413-s dhe për Efekte Pezulluese*, 8 nëntor 2021.

¹⁰⁴ F00428, Trupi Gjykses, *Urdhër për Planin e Punës dhe Caktimin e Afateve për Hapat e Tjerë të Procesit (“Urdhri për Planin e Punës i 9 Nëntorit 2021”)*, 9 nëntor 2021.

¹⁰⁵ Urdhri për Planin e Punës i 9 Nëntorit 2021, para. 10, 14, 16(a), 17.

76. Më 10 nëntor 2021, Prokurori i Specializuar mbylli zyrtarisht paraqitjen e provave të Prokurorisë.¹⁰⁶

77. Më 15 nëntor 2021, në vijim të masave të ZPS-së dhe kërkesës pasuese në lidhje me shënimin zyrtar për kontaktin,¹⁰⁷ Trupi Gjykses urdhëroi ZPS-në që të nxirrte për Mbrojtjen versionin e redaktuar të shënimit.¹⁰⁸

78. Më 18 nëntor 2021, ZPS-ja shtoi një material ("materiali 202") në njoftimin sipas rregullës 102(3) dhe kundërshtoi paraprakisht nxjerrjen e materialit 202 për Mbrojtjen.¹⁰⁹ Më 29 nëntor 2021, të dy ekipet e Mbrojtjes u përgjigjën dhe kërkuan nxjerrjen e materialit.¹¹⁰

79. Më 26 nëntor 2021, në vijim të parashtrimeve të palëve,¹¹¹ Trupi Gjykses lëshoi vendimin me të cilin refuzoi mocionet e Mbrojtjes për rrëzimin e akuzave.¹¹²

80. Më 29 nëntor 2021, në pajtim me Urdhrin për Planin e Punës të 9 Nëntorit 2021, Mbrojtja e Gucatit dorëzoi listën e dëshmitarëve dhe të provave materiale në pajtim me rregullën 119(2) të Rregullores.¹¹³ Të njëjtën ditë, më 29 nëntor 2021, Mbrojtja e

¹⁰⁶ F00431, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë për Mbylljen e Paraqitjes së Provave*, 10 nëntor 2021.

¹⁰⁷ F00433, Prokurori i Specializuar, *Raport i Prokurorisë në lidhje me Materialin 201 në Njoftimin sipas Rregullës 103(2)*, 12 nëntor 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-4, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. *Shih gjithashtu F00433/CONF/RED*, konfidencial.

¹⁰⁸ F00435, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë në lidhje me Materialin 201 në Njoftimin sipas Rregullës 103(2)*, 15 nëntor 2021, konfidencial. *Shih gjithashtu F00442 ashtu F00435/RED*.

¹⁰⁹ F00442, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë për Materialin Shtesë dhe Kundërshtimin e Nxjerrjes*, 18 nëntor 2021, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

¹¹⁰ F00453, Mbrojtja e Gucatit, *Përgjigje ndaj Njoftimit të Prokurorisë për Materialin Shtesë dhe Kundërshtimin e Nxjerrjes*, 29 nëntor 2021, konfidenciale; F00454, Mbrojtja e Haradinajt, *Përgjigje ndaj 'Njoftimit të Prokurorisë për Materialin Shtesë dhe Kundërshtimin e Nxjerrjes'*, 29 nëntor 2021, konfidenciale.

¹¹¹ F00439, Mbrojtja e Gucatit, *Mocion për Rrëzimin e Akuzave në Përputhje me Rregullën 130*, 17 nëntor 2021, konfidencial; F00440, Mbrojtja e Haradinajt, *Mocion i Mbrojtjes për Rrëzimin e Akuzave sipas Rregullës 130*, 17 nëntor 2021, konfidencial; F00447, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Kërkesave për Rrëzimin e Akuzave*, 24 nëntor 2021. *Shih gjithashtu F00439/RED, F00440/RED; F00447/RED*.

¹¹² F00450, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Mocionet për Rrëzimin e Akuzave*, 26 nëntor 2021.

¹¹³ F00460, Mbrojtja e Gucatit, *Parashtrim nga Mbrojtja i Listës së Dëshmitarëve të Pritshëm, me Shtojcën 1 dhe Shtojcën 2*, 29 nëntor 2021.

Haradinajt dorëzoi listën e dëshmitarëve në pajtim me rregullën 119(2)(a) të Rregullores.¹¹⁴

81. Më 30 nëntor 2021, Trupi Gjykses lëshoi një urdhër për caktimin e datës së konferencës përgatitore për Mbrojtjen.¹¹⁵

82. Më 2 dhjetor 2021, Trupi Gjykses mbajti konferencën përgatitore për Mbrojtjen dhe caktoi datën për hapjen e paraqitjes së provave nga Mbrojtja, si dhe autorizoi Mbrojtjen e Haradinajt që të bënte deklaratën hyrëse pas përfundimit të paraqitjes së provave nga Mbrojtja e Gucatit.¹¹⁶ Trupi Gjykses gjithashtu caktoi datat e synuara për mbylljen a paraqitjes së provave nga Mbrojtja dhe për mbylljen e gjykimit.¹¹⁷ Trupi Gjykses urdhëroi Mbrojtjen e Haradinajt të dorëzonte listën e provave materiale sipas rregullës 119(2)(b) të Rregullores, dhe urdhëroi të dy ekipet e Mbrojtjes të dorëzonin lista të përditësuar të provave materiale në pajtim me Urdhrin për Zhvillimin e Procedurave (“Urdhri për Listat e Provave Materiale”).¹¹⁸ Në përfundim të konferencës përgatitore për Mbrojtjen, Trupi Gjykses lëshoi një urdhër gojor lidhur me kërkesën e ZPS-së për përjashtimin tërësisht ose pjesërisht të dëshmitarëve të disa dëshmitarëve të Mbrojtjes.¹¹⁹

¹¹⁴ F00461, Mbrojtja e Haradinajt, *Parashtrim i Mbrojtjes sipas Rregullës 119 në Emër të Nasim Haradinajt*, 29 nëntor 2021, me Shtojcën 1, publike, dhe Shtojcën 2, konfidenciale.

¹¹⁵ F00463, Trupi Gjykses, *Urdhër për Caktimin e Datës së Konferencës Përgatitore për Mbrojtjen*, 30 nëntor 2021.

¹¹⁶ Transkripti, 2 dhjetor 2021, f. 2109 (Urdhër Gojor për Caktimin e Datës për Deklaratat Hyrëse të Mbrojtjes dhe për Paraqitjen e Provave nga Mbrojtja).

¹¹⁷ Transkripti, 2 dhjetor 2021, f. 2110-2111 (Urdhër Gojor për Caktimin e Datës së Synuar për Mbylljen e Paraqitjes së Provave nga Mbrojtja; Urdhër Gojor për Caktimin e Datës së Synuar për Mbylljen e Gjykimit).

¹¹⁸ Transkripti, 2 dhjetor 2021, f. 2112 (Urdhër Gojor për Mbrojtjen për Dorëzimin e Listave të Përditësuar të Provave Materiale) (“Urdhri për Listat e Provave Materiale”).

¹¹⁹ Transkripti, 2 dhjetor 2021, f. 2105-2107 (Përmbledhje e Vendimit të Trupit Gjykses mbi Mocionet e ZPS-së për Përjashtimin e Dëshmitarëve të Mbrojtjes). *Shih gjithashtu* F00312, Prokurori i Specializuar, *Kërkesa të Prokurorisë lidhur me Dëshmitarët e Mbrojtjes*, 15 shtator 2021; F00329, Mbrojtja e Gucatit, *Përgjigje ndaj Kërkesave të Prokurorisë lidhur me Dëshmitarët e Mbrojtjes*, 27 shtator 2021; F00330, Mbrojtja e Haradinajt, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Kërkesave të Prokurorisë lidhur me Dëshmitarët e Mbrojtjes*, 27 shtator 2021; F00376, Mbrojtja e Haradinajt, *Parashtrim i Aktespertizës nga Mbrojtja e z. Haradinajt*, 15 tetor 2021; Transkripti, 18 tetor 2021, f. 817; F00388, Prokurori i Specializuar, *Kundërshtim i Prokurorisë ndaj Ekspertit dhe Aktespertizës së Propozuar nga Mbrojtja*, 22 tetor 2021; F00410, Mbrojtja e Haradinajt, *Përgjigje e*

83. Gjithashtu më 2 dhjetor 2021, pas zgjatjes së afatit fillestar dhe në pajtim me Urdhrin për Listat e Provave Materiale, Mbrojtja e Haradinajt dorëzoi një listë paraprake të provave materiale.¹²⁰

84. Më 3 dhjetor 2021, u hap paraqitja e provave nga Mbrojtja dhe Mbrojtja e Gucatit bëri deklaratën hyrëse.¹²¹

85. Të njëjtën ditë, më 3 dhjetor 2021, Trupi Gjykues nxori arsyet me shkrim për urdhrin gojor mbi kërkesat e ZPS-së për përjashtimin tërësisht apo pjesërisht të dëshmimeve të disa dëshmitarëve të Mbrojtjes, që u dha në përfundim të konferencës përgatitore për Mbrojtjen (“Vendimi lidhur me Dëshmitarët e Mbrojtjes”)¹²² dhe refuzoi të përjashtonte dëshminë e DW1246-ës, duke qenë se dëshmia e propozuar mund të kishte lidhje me pretendimin për shtytje për kryerje të veprës penale.¹²³

86. Më 6 dhjetor 2021, në pajtim me Urdhrin për Listat e Provave Materiale, Mbrojtja e Gucatit dorëzoi një listë të përditësuar të provave materiale.¹²⁴

87. Më 6 dhjetor 2021, filloi gjithashtu paraqitja e provave nga Mbrojtja e Gucatit.¹²⁵ Siç saktësohet më poshtë, Trupi Gjykues dëgjoi dëshmitë e paraqitura nga Mbrojtja e Gucatit gjatë pesë (5) ditë seancash.

Mbrojtjes ndaj Kundërshtimit të Prokurorisë për Ekspertin dhe Aktekspertizën e Propozuar nga Mbrojtja, 1 nëntor 2021, konfidenciale; F00426, Mbrojtja e Haradinajt, Parashtrim i Aktekspertizës nga Mbrojtja e z. Haradinajt, 9 nëntor 2021, me Shtojcën A, konfidenciale, dhe Shtojcën B, publike; F00438, Prokurori i Specializuar, Kundërshtim i Prokurorisë për Dëshmitarin Ekspert 18 dhe Aktekspertizën e Propozuar nga Mbrojtja, 16 nëntor 2021; F00444, Mbrojtja e Haradinajt, Përgjigje e Mbrojtjes së Haradinajt ndaj F00438, 22 nëntor 2021; F00466, Prokurori i Specializuar, Kërkesa të Mëtejshme të Prokurorisë lidhur me Dëshmitarët e Mbrojtjes, 1 dhjetor 2021. Shih gjithashtu F00410/RED.

¹²⁰ F00469, Mbrojtja e Haradinajt, Parashtrim i Listës Paraprake të Provave Materiale, 2 dhjetor 2021.

¹²¹ Transkripti, 3 dhjetor 2021, f. 2115-2132.

¹²² F00470, Trupi Gjykues, Vendim mbi Kërkesat e Prokurorisë lidhur me Dëshmitarët e Propozuar nga Mbrojtja (“Vendimi lidhur me Dëshmitarët e Mbrojtjes”), 3 dhjetor 2021.

¹²³ Vendimi lidhur me Dëshmitarët e Mbrojtjes, para. 77-79.

¹²⁴ F00475, Mbrojtja e Gucatit, Parashtrim i Listës së Provave Materiale në Pajtim me Paragrafin 60(e) të Urdhrit mbi Zhvillimin e Procedurave, 6 dhjetor 2021.

¹²⁵ Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2151.

88. Nga 6 deri në 8 dhjetor 2021, Trupi Gjykses dëgjoi dëshminë e z. Gucati (DW1240).¹²⁶

89. Më 7 dhjetor 2021, Trupi Gjykses refuzoi nxjerrjen e materialit 202 për Mbrojtjen.¹²⁷

90. Më 8 dhjetor 2021, Trupi Gjykses i miratoi Mbrojtjes së Haradinajt lejen për apelimin e disa konstatimeve të caktuara në Vendimin për Dëshmitarin e Mbrojtjes.¹²⁸

91. Nga 9 deri në 10 dhjetor 2021, Trupi Gjykses dëgjoi ose pranoi prova nga gjashtë dëshmitarë të tjerë të thirrur nga Mbrojtja e Gucatit: Taibe Miftari (DW1241), Elmedina Ballhazhi (DW1242), Pren Marashi (DW1243), Metush Kryeziu (DW1244), Çelë Gashi (DW1245) dhe Xhozef Bauden (Joseph Bowden) (DW1248).¹²⁹

92. Më 10 dhjetor 2021, pas një zgjatjeje tjetër të afatit të caktuar më parë,¹³⁰ Mbrojtja e Haradinajt dorëzoi një listë të përditësuar të provave materiale.¹³¹

93. Më 10 dhjetor 2021, Trupi Gjykses miratoi kërkesën e Mbrojtjes për t'i marrë më tej në pyetje dëshmitarët W04841 dhe W04842 të ZPS-së, mbi bazën se nxjerrja e vonuar e disa materialeve u shkaktua nga kundërshtimet e ZPS-së për nxjerrjen e tyre dhe se ato materiale, të cilat Trupi Gjykses urdhëroi në fund që të nxirreshin, Mbrojtja i mori pas mbylljes së paraqitjes së provave nga ZPS-ja dhe, si rrjedhojë, nuk pati mundësi t'i përdorte kur i mori në pyetje këta dëshmitarë.¹³²

¹²⁶ DW1240 (Hysni Gucati), Transkriptet, 6-8 dhjetor 2021, f. 2151-2439.

¹²⁷ F00479, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Nxjerrjen e Materialit 202*, 7 dhjetor 2021, konfidencial.

¹²⁸ F00484, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Leje për Apelimin e Vendimit F00470*, 8 dhjetor 2021.

¹²⁹ DW1241 (Taibe Miftari), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2450-2476; DW1242 (Elmedina Ballhazhi), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2479-2514; DW1243 (Pren Marashi), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2516-2543; DW1244 (Metush Kryeziu), Transkripti, 9 dhjetor 2021, f. 2545-2554; DW1245 (Çelë Gashi), Transkripti, 10 dhjetor 2021, f. 2573-2608; DW1248 (Xhozef Bauden), Transkripti, 10 dhjetor 2021, f. 2613-2615, dhe 1D00010 me provat materiale shoqëruese 1D00011-1D00018.

¹³⁰ Transkripti, 8 dhjetor 2021, f. 2342.

¹³¹ F00489, Mbrojtja e Haradinajt, *Listë e Përditësuar e Provave Materiale dhe Kërkesë për Leje për Përfshirjen e Provave Materiale Shtesë në Pajtim me Rregullën 119(2)(b)*, 10 dhjetor 2021.

¹³² Transkripti, 10 dhjetor 2021, f. 2608-2610 (Urdhër Gojor mbi Kërkesën e Mbrojtjes për të Marrë më tej në Pyetje Dëshmitarët W04841 dhe W04842 të ZPS-së).

94. Më 15 dhjetor 2021, pas autorizimit nga Trupi Gjykses, dëshmitarët W04841 dhe W04842 të ZPS-së u thirrën përsëri dhe u morën më tej në pyetje nga Mbrojtja e Gucatit.¹³³

95. Të njëjtën ditë, më 15 dhjetor 2021, Mbrojtja e Haradinajt bëri deklaratën hyrëse.¹³⁴ Pas kësaj dhe në vijim të kërkesës së Mbrojtjes së Haradinajt për shkak të gjendjes shëndetësore të mbrojtësit kryesor, Trupi Gjykses i shtyu seancat gjyqësore deri më 11 janar 2022.¹³⁵

96. Më 17 dhjetor 2021, në vijim të kërkesës së Mbrojtjes së Gucatit për pranimin e provave jogojore,¹³⁶ Trupi Gjykses nxori vendim për pranimin e disa provave jogojore dhe refuzoi pranimin e të gjitha materialeve të tjera.¹³⁷

97. Më 6 janar 2022, pas autorizimit nga Trupi Gjykses për përfshirjen e provave materiale dhe zgjatjen e mëtejme të afatit të mëparshëm, Mbrojtja e Haradinajt dorëzoi një listë të përditësuar të provave materiale.¹³⁸

98. Më 7 janar 2022, paneli i Gjykatës së Apelit nxori një vendim me të cilin miratoi pjesërisht apelin e ndërmjetëm të Mbrojtjes së Haradinajt kundër Vendimit lidhur me Dëshmitarët e Mbrojtjes.¹³⁹

¹³³ W04841 (Zdenka Pumper), Transkripti, 15 dhjetor 2021, f. 2621-2626; W04842 (Miro Jukiq), Transkripti, 15 dhjetor 2021, f. 2626-2637.

¹³⁴ Transkripti, 15 dhjetor 2021, f. 2663-2674.

¹³⁵ Transkripti, 15 dhjetor 2021, f. 2656-2660 (Vendim Gojor mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Haradinajt për Shtyrje të Gjykimit).

¹³⁶ F00487, Mbrojtja e Gucatit, *Kërkesë e Mbrojtjes për Pranimin e Provave Jogojore dhe Çështje të Lidhura me To*, 10 dhjetor 2021, konfidenciale; F00488, Mbrojtja e Haradinajt, *Bashkimi i Mbrojtjes së Haradinajt me Kërkesën e Mbrojtjes së Gucatit për Pranimin e Provave Jogojore dhe Çështje të Lidhura me To*, 10 dhjetor 2021; Transkripti, 15 dhjetor 2021, f. 2637-2638; F00496, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Mbrojtjes për Pranimin e Provave Jogojore dhe Çështje të Lidhura me To*, 15 dhjetor 2021. *Shih gjithashtu F00487/RED.*

¹³⁷ F00502, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Pranimin e Provave Jogojore dhe Çështje të Lidhura me To*, 17 dhjetor 2021, para. 46(b) dhe (f).

¹³⁸ F00511, Mbrojtja e Haradinajt, *Listë Përmbledhëse e Dëshmitarëve dhe Provave Materiale e Mbrojtjes së Haradinajt*, 6 janar 2022.

¹³⁹ IA006-F00006, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit mbi Kërkesat e Prokurorisë në lidhje me Dëshmitarët e Propozuar të Mbrojtjes*, 7 janar 2022.

99. Më 11 janar 2022, filloi paraqitja e provave nga Mbrojtja e Haradinajt.¹⁴⁰ Sikurse shtjellohet në vijim, Trupi Gjykses dëgjoi provat e Mbrojtjes së Haradinajt gjatë shtatë (7) ditë seancash.

100. Midis 11 dhe 14 janarit 2022, Trupi Gjykses dëgjoi dëshminë e z. Haradinaj (DW1249).¹⁴¹

101. Më 12 dhe 14 janar 2022, ZPS-ja shtoi dy materiale (“materiali 203” dhe “materiali 204”) në njoftimin sipas rregullës 102(3) dhe paraqiti paraprakisht kundërshtimet e saj ndaj nxjerrjes së tyre për Mbrojtjen.¹⁴² Më 20 dhe 21 janar 2022, Mbrojtja e Haradinajt dhe Mbrojtja e Gucatit dorëzuan përgjigjet përkatëse, me të cilat kërkuan nxjerrjen e materialit 203 dhe materialit 204.¹⁴³

102. Më 14 janar 2022, Trupi Gjykses hodhi poshtë kundërshtimet e ZPS-së dhe pranoi deklaratën dhe shtesën e deklaratës së Rashit Qalajt (DW1246), sepse konstatoi që dukej se dëshminë e tij Mbrojtja po e paraqiste si një dëshmi që kishte lidhje me pretendimin për shtytje për kryerje të veprës penale.¹⁴⁴

103. Më 14, 21, 24 dhe 28 janar 2022, Trupi Gjykses dëgjoi dëshmitë e tre dëshmitarëve të tjerë të thirrur nga Mbrojtja e Haradinajt: Rashit Qalaj (DW1246), Ana Majers [Anna Myers] (DW1252) dhe Robert Rid [Robert Reid] DW1253.¹⁴⁵

¹⁴⁰ Transkripti, 11 janar 2022, f. 2692.

¹⁴¹ Transkriptet e datave 11-14 janar 2022, f. 2692-3047.

¹⁴² F00517, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë për një Material Shtesë dhe Kundërshtim për Nxjerrjen e Tij*, 12 janar 2022, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00520, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë për Përfshirjen e Materialit 204 dhe Kundërshtim për Nxjerrjen e Tij*, 14 janar 2022, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

¹⁴³ F00526, Mbrojtja e Haradinajt, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Parashtrimeve F00517 dhe F00520 të Prokurorisë*, 20 janar 2022, konfidenciale; F00528, Mbrojtja e Gucatit, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Kundërshtimit të Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialeve 203 dhe 204 (Parashtrimet F00517 dhe F00520)*, 21 janar 2022, konfidenciale.

¹⁴⁴ Transkripti, 14 janar 2022, f. 3056-3057.

¹⁴⁵ DW1246 (Rashit Qalaj), Transkripti, 14 janar 2022, f. 3052-3083; DW1252 (Ana Majers), Transkripti, 21 janar 2022, f. 3103-3188; DW1253 (Robert Reid), Transkriptet e datave 24-28 janar 2022, f. 3205-3367.

104. Më 25 janar 2022, Trupi Gjykses miratoi kërkesat e ZPS-së për mosnxjerrjen e materialeve 203 dhe 204.¹⁴⁶

105. Të njëjtën ditë, më 25 janar 2022, ZPS-ja shtoi një material ("materiali 205") në njoftimin e saj sipas rregullës 102(3) dhe paraqiti paraprakisht kundërshtim ndaj nxjerrjes së tij për Mbrojtjen.¹⁴⁷

106. Më 27 dhe 28 janar 2022, Mbrojtjet dorëzuan përgjigjet përkatëse dhe kërkuan nxjerrjen e materialit 205.¹⁴⁸

107. Më 28 janar 2022, Trupi Gjykses miratoi kërkesat e ZPS-së për mosnxjerrjen e materialit 205.¹⁴⁹

108. Më 31 janar 2022, Trupi Gjykses mbajti konferencë për ecurinë e çështjes për të diskutuar me palët hapat e mëtejshëm në gjykim.¹⁵⁰ Në konferencë, ZPS-ja bëri të ditur se nuk do të kërkonte të paraqiste kundërprova; për rrjedhojë, pyetja nëse Mbrojtja synonte të paraqiste prova në kundërpërgjigje ndaj tyre ishte e tejkualuar.¹⁵¹

109. Më 1 shkurt 2022, në vijim të kërkesës përkatëse të Mbrojtjes,¹⁵² Trupi Gjykses refuzoi kërkesën e Mbrojtjes për leje për apelimin ose rishqyrtimin e vendimit me të cilin ishte miratuar mosnxjerrja e materialit 205.¹⁵³

¹⁴⁶ F00533, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së në lidhje me Materialet 203 dhe 204*, 25 janar 2022, konfidencial.

¹⁴⁷ F00534, Prokurori i Specializuar, *Njoftim i Prokurorisë për Përfshirjen e Materialit 205 dhe Kundërshtim për Nxjerrjen e Tij*, 24 janar 2022, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

¹⁴⁸ F00536, Mbrojtja e Haradinajt, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Parashtrimit F00534 të Prokurorisë*, 27 janar 2022, konfidenciale; F00539, Mbrojtja e Gucatit, *Përgjigje e Mbrojtjes ndaj Njoftimit të Prokurorisë për Përfshirjen e Materialit 205 dhe Kundërshtimit për Nxjerrjen e Tij*, 28 janar 2022, konfidenciale.

¹⁴⁹ F00541, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesat e ZPS-së në lidhje me Materialin 205*, 28 janar 2022, konfidencial.

¹⁵⁰ Transkripti, 31 janar 2022, f. 3380-3419.

¹⁵¹ Transkripti, 31 janar 2022, f. 3391-3392.

¹⁵² Transkripti, 31 janar 2022, f. 3381-3385; F00543, Mbrojtja e Haradinajt, *Kërkesë e Mbrojtjes për Leje për Apel në bazë të Autorizimit nga Vendimi KSC-BC-2020-07/F00541*, 31 janar 2022.

¹⁵³ F00546/COR, Trupi Gjykses, *Version i Korrigjuar i Vendimit mbi Kërkesën për Autorizim ose Rishqyrtim të Vendimit F00541*, 1 shkurt 2022.

110. Më 1 shkurt 2022, Trupi Gjykses udhëzoi Mbrojtjen që të mbyllte paraqitjen e provave në pajtim me rregullën 131 të Rregullores.¹⁵⁴

111. Më 2 shkurt 2022, në përputhje me urdhrin e Trupit Gjykses, të dy ekipet e Mbrojtjes i mbyllën zyrtarisht paraqitjet e provave të tyre.¹⁵⁵

112. Më 3 shkurt 2022, Trupi Gjykses nxori tri vendime. Së pari, Trupi Gjykses evidentoi faktet e pranuar nga palët.¹⁵⁶ Së dyti, Trupi Gjykses pranoi dy materiale si prova, në përputhje me rregullën 132 të Rregullores.¹⁵⁷ Së treti, Trupi Gjykses mbylli fazën e paraqitjes së provave në këtë çështje gjyqësore (“Vendimi i 3 Shkurtit 2022”).¹⁵⁸

113. Më 3 mars 2022, në përputhje me Vendimin e 3 Shkurtit 2022, palët dorëzuan dosjet gjyqësore përfundimtare (përkatësisht “dosja gjyqësore përfundimtare e ZPS-së”; “dosja gjyqësore përfundimtare e Gucatit”; “dosja gjyqësore përfundimtare e Haradinajt”).¹⁵⁹

114. Më 10 mars 2022, në vijim të kërkesës së ZPS-së,¹⁶⁰ Trupi Gjykses urdhëroi Mbrojtjen që, deri më 14 mars 2022, të dorëzonte çdo provë tjetër që dëshironte të paraqiste në lidhje me përcaktimin e dënimit.¹⁶¹

¹⁵⁴ F00547, Trupi Gjykses, *Urdhër sipas Rregullës 131 të Rregullores*, 1 shkurt 2022.

¹⁵⁵ F00549, Mbrojtja e Gucatit, *Njoftim i Mbrojtjes për Mbylljen e Paraqitjes së Provave*, 2 shkurt 2022; F00550, Mbrojtja e Haradinajt, *Njoftim i Mbrojtjes për Mbylljen e Paraqitjes së Provave*, 2 shkurt 2022 (mban datën 1 shkurt 2022; dorëzuar për protokollim më 2 shkurt 2022).

¹⁵⁶ F00551, Trupi Gjykses, *Vendim për Evidentimin e Fakteve të Pranuar*, 3 shkurt 2022.

¹⁵⁷ F00552, Trupi Gjykses, *Vendim në Përputhje me Rregullën 132 të Rregullores*, 3 shkurt 2022.

¹⁵⁸ F00553, Trupi Gjykses, *Vendim për Mbylljen e Paraqitjes së Provave dhe për Parashtrimet në Përputhje me Rregullat 134(b), (d) dhe 159(6) të Rregullores* (“Vendimi i 3 Shkurtit 2022”), 3 shkurt 2022.

¹⁵⁹ F00565, Prokurori i Specializuar, *Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë* (“Dosja Gjyqësore Përfundimtare e ZPS-së”), 3 mars 2021, konfidenciale, me Shtojcën 1, publike; *shih gjithashtu* F00565/RED; F00566/RED, Mbrojtja e Haradinajt, *Dosja Gjyqësore Përfundimtare në Emër të Nasim Haradinajt* (“dosja gjyqësore përfundimtare e Haradinajt”), 3 mars 2022; F00567, Mbrojtja e Gucatit, *Dosja Gjyqësore Përfundimtare në Emër të Hysni Gucatit* (“dosja gjyqësore përfundimtare e Gucatit”), 3 mars 2022 (mban datën 3 mars 2022; dorëzuar për protokollim më 4 shkurt 2022), konfidenciale. *Shih gjithashtu* F00565/RED; F00566/RED; F00567/RED.

¹⁶⁰ F00568, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Nxjerrjen e Provave Shtesë në lidhje me Përcaktimin e Dënimit*, 7 mars 2022.

¹⁶¹ F00572, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së për Nxjerrjen e Provave Shtesë në lidhje me Përcaktimin e Dënimit*, 10 mars 2022.

115. Më 14 dhe 15 mars 2022, Mbrojtja e Gucatit dhe Mbrojtja e Haradinajt dorëzuan përkatësisht njëmbëdhjetë dhe gjashtë deklarata, për t'u marrë parasysh në përcaktimin e dënimit.¹⁶² Më 16 mars 2022, Trupi Gjykses e pranoi një nga deklaratat pjesërisht, ndërsa deklaratat e tjera i pranoi në tërësi.¹⁶³

116. Nga 14 deri më 17 mars 2022, në përputhje me urdhrin e Trupit Gjykses¹⁶⁴ dhe në pajtim me rregullën 135 të Rregullores, Trupi Gjykses dëgjoi deklaratat përmbyllëse të palëve.¹⁶⁵ Më tej, Trupi Gjykses dëgjoi parashtrimet e palëve në lidhje me përcaktimin e dënimit në rast të vendimit të fajësisë,¹⁶⁶ si dhe deklaratat e secilit të akuzuar.¹⁶⁷ Trupi Gjykses u shpreh gjithashtu se, në rast se të një vendimi fajësie për cilëndo Pikë të Aktakuzës, në shqiptimin e aktgjykimit do të përcaktohej edhe dënimi përkatës.¹⁶⁸

117. Më 17 mars 2022, Trupi Gjykses mbylli gjykimin e çështjes.¹⁶⁹

118. Më 6 prill 2022, Paneli i Gjykatës së Apelit, në një vendim përmbledhës, rrëzoi të dy apelet e ndërmjetme të Mbrojtjes së Haradinajt kundër vendimeve të Trupit Gjykses për rishikimin e paraburgimit.¹⁷⁰

¹⁶² Nxjerrja 82; Nxjerrja 83; Nxjerrja 84.

¹⁶³ F00578, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Provat në lidhje me Përcaktimin e Dënimit*, 16 mars 2022, para. 23(b) dhe (c).

¹⁶⁴ Vendimi i 3 Shkurtit 2022, para. 26(c).

¹⁶⁵ Transkriptet e datave 14-17 mars 2022, f. 3424-3768.

¹⁶⁶ Transkripti, 17 mars 2022, f. 3770-3845.

¹⁶⁷ Transkripti, 17 mars 2022, f. 3845-3853.

¹⁶⁸ Transkripti, 17 mars 2022, f. 3853-3854 (Urdhër Gojor mbi Procedurën që do të Ndiqet Lidhur me Përcaktimin e Dënimit në Rast të Vendimit të Fajësisë).

¹⁶⁹ Transkripti, 17 mars 2022, f. 3855.

¹⁷⁰ IA007-F00004 & IA008-F00004, Paneli i Gjykatës së Apelit, *Vendim Përmbledhës mbi Apelet e Nasim Haradinajt kundër Vendimeve mbi Rishikimin e Paraburgimit*, 6 prill 2022.

119. Më 9 maj 2022, me kërkesë të Mbrojtjes së Gucatit,¹⁷¹ Trupi Gjykues një vizitë triditore të z. Gucati si i paraburgosur, për arsye humanitare bindëse.¹⁷²

120. Më 17 maj 2022, Trupi Gjykues refuzoi kërkesën e Mbrojtjes për leje për të paraqitur parashtrime të mëtejshme në lidhje me nxjerrjen e materialeve.¹⁷³

¹⁷¹ F00599, Mbrojtja e Gucatit, *Kërkesë e Gucatit për Lirim të Përkohshëm për Arsye Humanitare*, 9 maj 2022, konfidenciale, me katër shtojca konfidenciale. *Shih gjithashtu F00601, Prokurori i Specializuar, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Gucatit për Lirim të Përkohshëm për Arsye Humanitare*, 9 maj 2022; F00602, Administratorja, *Parashtrimet e Administratores mbi Kërkesën e Gucatit për Lirim të Përkohshëm për Arsye Humanitare*, 9 maj 2022, konfidenciale dhe *ex parte*. *Shih gjithashtu F00602/RED*.

¹⁷² F00604, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Gucatit për Lirim të Përkohshëm për Arsye Humanitare*, 9 maj 2022, konfidencial dhe *ex parte*. *Shih gjithashtu F00604/RED*.

¹⁷³ F00610, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Leje për të Bërë Parashtrime të Mëtejshme në lidhje me Nxjerrjen e Materialeve*, 17 maj 2022. *Shih gjithashtu F00605, Mbrojtja e Gucatit, Kërkesë e Gucatit për Leje për të bërë Parashtrime të Mëtejshme në lidhje me Nxjerrjen e Materialeve*, 12 maj 2022; F00606, Mbrojtja e Haradinajt, *Kërkesë e Haradinajt për Leje për të Bërë Parashtrime të Mëtejshme në lidhje me Nxjerrjen e Materialeve*, 12 maj 2022; F00608, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Kërkesave të Mbrojtjes në lidhje me Nxjerrjen e Materialeve*, 16 maj 2022.